

V E N D I M
Nr.542, datë 21.8.1998

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.346,
DATË 8.1.1996 “PËR PROKURIMIN ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE
NË MIRËMBAJTJEN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE TË RRJETIT RURAL
DHE URBAN TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” DHE NR. 903, DATË 30.12.1996
“PËR PROKURIMIN ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
MIRËMBAJTJES SË RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE ATIJ RURAL”**

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.346, datë 8.1.1996 “Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike në mirëmbajtjen e rrjetit rrugor kombëtar dhe të rrjetit rural e urban të Republikës së Shqipërisë” në pikën 1 të paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Drejtoritë rajonale rrugore, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, si dhe njësitë organizative pranë organeve të pushtetit lokal, të kryejnë, me fondet buxhetore, shërbimet e mirëmbajtjes, si vijon:

- kryerja dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal;
- mbyllja e gropave në rrugë;
- kryerja dhe përcaktimi i shkallës së sigurisë rrugore dhe inxhinieria e trafikut;
- mirëmbajtja dimërore (pastrimi nga dëbora, shpërndarja e kripës dhe e skorjeve);
- pastrimi dhe mirëmbajtja e thjeshtë e veprave të artit, si dhe konstatimi i dëmtimeve të tyre;
- pastrimi periodik i kanaleve anësorë, tombinove etj., dhe kujdesi për bimësinë.

2. Për rastet e emergjencës dimërore, të terreneve të vështira malore, rrezikshmërisë së punimeve, drejtoritë rajonale rrugore dhe njësitë organizative pranë organeve të pushtetit lokal, me miratimin e dikasterit përkatës, mund të prokurojnë punimet me sipërmarrës.”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.903, datë 30.12.1996, pika 5 dhe 6 shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Transportit që, pas përfundimit të procedurave të dorëzimit të inventarit fizik të rrugëve, objekteve ndërtimore, makinerive e pajisjeve, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve në organet e pushtetit lokal, sipas dokumentacionit të dorëzuar në Ministrinë e Pushtetit Lokal, të kryejnë procedurat e privatizimit të makinerive, pajisjeve dhe objekteve ndërtimore të sektorëve të mirëmbajtjes rrugore, në varësi të drejtorive rajonale rrugore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

